



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

DI Nr. / Br 331 / 12

Nr. i fq. / Br. si -5-

Data: / Datum 27. 12. 2012

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**REGULLORE
PËR
PROCEDURAT DHE KRITERET E VENDOSJES DHE MIRËMBAJTJES SË
PËRMENDOREVE, BUSTEVE, SIMBOLEVE, MONUMENTEVE DHE
PLLAKAVE PËRKUJTIMORE**

Vushtrri, 2012

Në mbështetje të neneve 12.2 "c" dhe 17 "f" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të Republikës së Kosovës nr. 28/2008 dhe të dispozitave të nenit 41.2 "c" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2012 miratoi këtë:

R R E G U L L O R E
P Ë R
PROCEDURAT DHE KRITERET E VENDOSJES DHE MIRËMBAJTJES SË
PËRMENDOREVE, BUSTEVE, SIMBOLEVE, MONUMENTEVE DHE
PLLAKAVE PËRKUJTIMORE

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1
Qëllimi

Me këtë rregullore, përcaktohen procedurat dhe kriteret për vendosjen dhe mirëmbajtjen e përmendoreve, busteve, simboleve, monumenteve dhe pllakave përkujtimore në hapësirat publike, brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2
Përkufizime

Shpjegime të kuptimeve të fjalëve që përdoren në këtë rregullore:

Përmendore-ja, – (shtatore, përkujtesë) vepër arkitekture ose skulpture e vendosur diku, për të përjetësuar kujtimin e një ngjarje historike a të një njeriu të shquar; ndërtim a shkrim me rëndësi historike, që ruhet si dëshmi e së kaluarës; figurë-vepër e shquar që ruhet brez pas brezi.

Busti – skulpturë që paraqet pjesën e sipërme të trupit të njeriut që nga mesi e lart ose kokën dhe një pjesë të kraharorit.

Simboli-e - 1) shkronjë ose shenjë e caktuar, që përdoret në mënyrë konvecionale për të paraqitur një element, një madhësi, një veprim 2) send, qenie, dukuri a veprim që është zgjedhur nga tradita shoqërore për të paraqitur një ide, një ndjenjë, 3) figurë me domethënie të dyfishtë, me anën e së cilës dukuritë e rëndësishme të botës përgjithësohen dhe mishërohen në mënyrë konkrete, 4) shembull i lartë për t'u ndjekur.

Monumenti-e – 1) përmendore, 2) ndërtesë madhështore a vepër arti me rëndësi historike.

Pllakë përkujtimore – pllakë zakonisht prej mermeri me një mbishkrim të gdhendur, që vendoset diku për të përkujtuar dikë a diçka.

Neni 3
Formimi i Komisionit

3.1 Komisioni mandator për përcaktimin e listës së lokacioneve dhe hapësirave për vendosjen e përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve për vlerësim të meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Vushtrrisë emërohet nga Kuvendi dhe duhet të pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit, aspektin gjinor dhe profesional duke përfshirë edhe shoqërinë civile (me theks të veçantë edhe anëtarët nga shoqatat e dala nga lufta).

3.2 Komisioni duhet të ketë 7 deri në 9 anëtarë.

3.3 Kuvendi i Komunës përmes Komisionit të mandator të Komunës bënë përcaktimin e listës së lokacioneve dhe hapësirave për vendosjen përmendoreve, busteve, simboleve, monumenteve dhe pllakave përkujtimore të vendosura në hapësirat publike.

Neni 4

Komuna si autoritet publik është përgjegjëse për menaxhimin e procedurës së vendosjes së përmendoreve, busteve, simboleve, monumenteve dhe pllakave përkujtimore të vendosura në hapësirat publike.

Neni 5

Kriteret për vendosje

5.1. Në hapësirat publike të përcaktuara paraprakisht nga Kuvendi, mund të vendosen përmendoret, busteve, simboleve, monumenteve dhe pllakave përkujtimore sipas kriterëve të shënuara më poshtë:

5.1.1 Të ketë iniciativë për vendosjen e përmendoreve, shtatoreve, busteve ose të simboleve, nga qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, me zotësi të veprimit të cilët kanë siguruar së paku 1000 (njëmijë) nënshkrime. Iniciativa duhet të jetë në harmoni me listën e miratuar për figurat dhe ngjarjet meritore.

5.1.2 Të ketë vlerësim nga Komisioni mandator, i përbërë nga profesionistë të cilët merren me vlerësimin e meritave të kontributdhënësve në secilën fushë të jetës shoqërore dhe profesionale të Komunës.

5.1.3 Duhet të ekzistojnë fakte të qëndrueshme të cilat janë të karakterit historik, arsimor, kulturor, profesional etj.

5.1.4 Të ketë projekt ideor për vendosje të përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve, duke përfshirë edhe arsyetimin dhe duke përshkruar qëllimin kryesor për vendosje në hapësirat publike.

5.1.5 Të pajiset me këtë leje urbanistike nga organi kompetent komunal.

5.1.6 Të merret vendim nga ana e KK-së për t'u realizuar neni 3.1.4 i Rregullores në fjalë.

Neni 6

6.1 Komisioni mandator për vlerësim të meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Vushtrrisë dhe tërësia etnike shqiptare, i propozon KK-së listën dhe prioritetin e trajtimit të personaliteteve dhe të ngjarjeve.

6.2 Lista miratohet nga Kuvendi i Komunës dhe mbetet në fuqi deri në revidimin e saj të ardhshëm nga KK-ja.

Neni 7

Vendosja e përmendoreve, busteve, simboleve, monumenteve dhe pllakave përkujtimore

7.1 Iniciativën për vendosjen e përmendoreve, busteve, simboleve, monumenteve dhe pllakave përkujtimore mund ta paraqesin edhe personat juridik dhe organizatat ndryshme që veprojnë në territorin e Komunës së Vushtrrisë. Iniciativa i dorëzohet Komisionit mandator për vlerësim të meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga hapësira e Komunës.

7.2 Komisioni mandator për vlerësim të meritave historike dhe shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga hapësira e Komunës, gjatë përcaktimit të propozimit përfundimtar për vendosjen e përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve, duhet të bashkëpunojë ngushtë me Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e Kuvendit për të zhvilluar procedurat dhe siguruar dokumentacionin e nevojshëm.

Neni 8

Për vendosjen e përmendoreve, busteve, simboleve, monumenteve dhe pllakave përkujtimore të vendosura në hapësirat publike, vendimin përfundimtar e merr Kuvendi i Komunës.

Neni 9

Përgjegjësitë e Komunës

9.1 Komuna si autoritet juridik dhe kompetent, është e obliguar:

9.1.1 Që t'i mirëmbajë përmendoret, shtatorët, bustet dhe simbolet të cilat janë të vendosura në hapësira publike.

9.1.2 Të ndërmer masa për mbrojtje të ambientit për rreth tyre të sugjeruara nga organi kompetent komunal, në pajtim me ligjin përkatës dhe aktet nënligjore.

Neni 10

Regjistri i përmendoreve, busteve, simboleve, monumenteve dhe pllakave përkujtimore

Të gjitha përmendoret, bustet, simbolet, monumentet dhe pllakat përkujtimore duhet të regjistrohen në regjistrë të posaçëm, të cilin e mbanë Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Arkivi komunal, si dhe në librat kadastrale.

Neni 11

Mirëmbajtja dhe mbrojtja

11.1 Punët të cilat duhet të ndërmerren me qëllim të restaurimit të përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve, mund të kryhen vetëm me leje të organit kompetent, respektivisht Kuvendit të Komunës, nëse ndryshe nuk është përcaktuar me ligjin përkatës.

11.2 Punimet që në ndonjë mënyrë ndryshojnë pamjen e përmendores, bustit, simbolit, monumentit apo të pllakës përkujtimore dhe qëllimin për çka është vendosur, mund të kryhen me pëlqim të organit kompetent sipas paragrafit 11.1 të këtij neni, ose nga komisioni i autorizuar nga ai.

Neni 12

Në rast se pronari i një përmendoreje, busti, simboli, monumenti ose pllake përkujtimore është i panjohur dhe se mbrojtja e tyre është me interes publik, atëherë Komuna dhe MKRS, apo organi tjetër i autorizuar me ligj i merr ato nën mbikëqyrje.

Neni 13

Dispozitat ndëshkuese (gjobat)

13.1 Me gjobë do të dënohet subjekti të cilit i janë besuar punët e mirëmbajtjes së përmendoreve, busteve, simboleve, monumenteve ose pllakave përkujtimore për personin fizik në shumë deri në 500 € (pesëqind euro), kurse personin juridik deri në 1000 € (njëmijë euro) në rast se:

13.1.1 Nuk i përmbahet masave mbrojtëse të përcaktuara nga organi kompetent në pajtim me ligjin përkatës.

13.1.2 Merr iniciativë lidhur me mirëmbajtjen, restaurimin apo mbrojtjen pa pëlqim të organit kompetent.

13.1.3 Nuk ekziston vendimi apo kundër vendimit të Kuvendit të Komunës, ndërmerren punime që në ndonjë mënyrë e ndërrojnë qëllimin dhe karakterin e përmendores, shtatores, bustit apo të simbolit të vendosur në hapësirën publike.

13.2 Gjoha e përcaktuar për persona fizik sipas nenit paraprak zbatohet edhe ndaj qytetarëve të cilët ndërmarrin veprime që i dëmtojnë përmendoret, bustet, simbolet, monumentet apo pllakat përkujtimore.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Trajtimi

14.1 Deri në miratimin e kësaj rregulloreje, të gjitha përmendoret, bustet, simbolet, monumentet dhe pllakat përkujtimore të vendosura në hapësira publike brenda territorit të Komunës, do të konsiderohen dhe trajtohen njësoj lidhur me mirëmbajtjen e tyre.

14.2 Përmendoret, bustet, simbolet, monumentet dhe pllakat përkujtimore të cilat gjenden jashtë hapësirave publike (varrezat, objektet fetare dhe hapësirat për rreth objekteve fetare dhe hapësirat private) nuk janë objekt i kësaj rregulloreje.

Neni 15

Zhvendosja

Zhvendosja e përmendoreve, busteve, simboleve, monumenteve dhe pllakave përkujtimore nga lokacioni ekzistues në një lokacion tjetër mund të bëhet vetëm me vendim të Kuvendit të Komunës, sipas iniciativës të paraqitur në pajtim me këtë rregullore.

Neni 16

Evidentimi

16.1 Autorizohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, që të bëjë evidentimin e të gjitha përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve të vendosura në hapësirat publike para dhe pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

16.2 Evidentimi duhet të bëhet në afat prej 90 ditësh nga dita e miratimit të kësaj rregulloreje.

16.3 Lista e përmendoreve, busteve, simboleve, monumenteve dhe pllakave përkujtimore të evidentuara do të jetë pjesë e kësaj rregulloreje.

16.4 Pjesë e kësaj rregulloreje do të jetë edhe lista e hapësirave publike në të cilat mund të bëhet vendosja e përmendoreve, busteve, simboleve, monumenteve dhe pllakave përkujtimore.

Neni 17

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 18

Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

